



UNMIK/RREG/2003/25  
6 korrik 2003

## RREGULLORE NR. 2003/25

### MBI KODIN E PËRKOHSHËM PENAL TË KOSOVËS

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik të vitit 1999 mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

I ndërgjegjshëm për traditën juridike e cila e përforcon ligjin e zbatueshëm në Kosovë,

Duke pranuar zhvillimet e fundit në ligjin penal ndërkombëtar dhe ligjin penal në rajon,

Me synim që të sigurohet pajtueshmëria e ligjeve penale që zbatohen në Kosovë me parimet e vendosura të ligjit ndërkombëtar dhe me tendencat e përgjithshme në reformën e ligjit penal modern,

Të vendosur për t'i luftuar të gjitha format e aktivitetit kriminal përmes shpalljes së një legjislacioni gjithëpërfshirës penal,

Duke pohuar se administrimi i drejtësisë duhet të ndërmerret në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut të pranura ndërkombëtarisht dhe duke i respektuar të drejtat e të pandehurve penalë dhe të viktimave,

Duke pranuar kontributin e madh që ka bërë komuniteti juridik i Kosovës në përgatitjen e Kodit të përkohshëm penal,

Pas konsultimit të Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës dhe pas marrjes parasysh të pikëpamjeve të tyre,

**Me anë të kësaj shpall** Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje.

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 6 korrik 2003. Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës hyn në fuqi nëntë (9) muaj pas datës së nënshkrimit, më 6 prill 2004.

Michael Steiner,  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm